



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P 713/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.11.2019, shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** “Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Eril B & B” sh.p.k. & “Adriatik” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-32766-08-05-2019, me objekt “*Mirembajtja e objekteve ndertimore ne Spitalin Rajonal Berat*”, me fond limit 5.333.347 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 16.08.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
- Ankimues:** Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Totila” sh.p.k. & “Rafin Company” sh.p.k.
Lagja “Çlirim”, Rruga “Antipatrea”, Godina me nr. Pasurie 2/120, zona kadastrale 8501, Berat
- Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Sheshi Skënderbej Nr. 3, Tiranë
- Subjekte të interesuar:** Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eril B&B” sh.p.k. & “Adriatik” sh.p.k.
Lagja nr.3, Rruga “Egnatia”, Zona Kadastrale 8514, Nr. Pasurie 3/65, Durrës

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 06.08.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-32766-08-05-2019, me objekt “Mirembajtja e objekteve ndertimore ne Spitalin Rajonal Berat”, me fond limit 5.333.347 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 16.08.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 16.08.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, në këtë procedurë prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eril B&B” sh.p.k. & “Adriatik” sh.p.k. 3.650.000 lekë, kualifikuar
2. “Modeste” sh.p.k. 3.874.259,72 lekë, skualifikuar
3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Totila” sh.p.k. & “Rafin Company” sh.p.k. 4.261.348 lekë, kualifikuar
4. “Meni” sh.p.k. 4.506.060 lekë, kualifikuar
5. “ED Konstruksion” sh.p.k. 5.113.842 lekë, kualifikuar

II.3. Në datën 22.08.2019 bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Totila” sh.p.k. & “Rafin Company” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.4. Në datën 29.08.2019, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Totila” sh.p.k. & “Rafin Company” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Eril B&B” sh.p.k. & “Adriatik” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht operatori ekonomik ankimues pretendon se:

[...]

Ne lidhje me procedurën e prokurimit të zhvilluar nga AK Agjensia e Blerjeve të Perqendruara me objekt: Mirembajtja e objekteve ndertimore në Spitalin Rajonal Berat me REF-32766-08-05-2019 me date zhvillimi 16/08/2019 Ora: 12:00, Komisioni i Vleresimit të ofertave pasi ka vlerësuar tenderin ka njoftuar në sistemin elektronik të prokurimit klasifikimin e ofertuesve, nga ku rezulton se oferta e paraqitur nga ana jone është renditur e dyta. Për sa i përket vleresimit nuk kemi dakord pasi nuk janë zbatuar udhëzimet perkatëse nga komisioni i vleresimit të ofertave, pasi është në shkelje të ligji nr 9643 date 20.11.2006 Për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe VKM nr.914 date 29. 12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenit 56 të LPP

“1. Kur autoriteti kontraktor verën se një ose me shumë oferta për kontratat e mallrave, puneve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vleresimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik perkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 diteve pune shpjegime për elemente të vecanta të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndertimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara,*
- b) zgjidhjet teknik të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve*
- c) origjinalitetin e puneve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi*
- c) zbatueshmerinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi*

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u keshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit

te infomacionit te paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo eshte e rregullt ne te gjitha elementet e saj. Duke u nisur nga me lart oferta e renditur ne vend te pare eshte nje oferte e pavlefshme dhe nuk eshte perlllogaritur ne menyren e duhur dhe per me teper komisioni i vleresimit e ka kualifikuar pa te drejte pasi duhet ta skualifikonte nga renditja. Oferta jone eshte e rregullt sipas percaktimeve ne LPP, VKM dhe Udhezimet ne fuqi per prokurimin publik dhe kerkojme qe kjo procedure te rivleresohet edhe njehere pasi ka abuzime te dukshme.

Edhe ne dokumentat standarte te tenderit jane te percaktuara fazat e vleresimit nder te tjera citohet se ne cdo rast ofertuesi ka detyrimin te argumentojte dhe te dokumentojte me prova shkresore sqarimet mbi elementin/elemente e vecante te ofertes, ne perputhje me kerkesat e nenit 56 te LPP. Keto faza nuk jane marre parasysht nga komisioni i vleresimit te ofertave ne momentin e vleresimit te procedures se prokurimit. Kemi dyshime te forta qe eshte shkelur LPP pasi nje nga parimet baze te ketij ligji jane:

a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabarte i ofertuesve ose kandidateve

b) transparence ne procedural e prokurimit

c) barazi ne trajtimin e kerkesave dhe te detyrimeve, qe u ngarkohen ofertuesve ose kandidateve Nisur nga tipologjia e objektit e cila shtrihet ne qarkun e Beratit me objekt mirembajtja e Spitalit Rajonal Berat, oferta e paraqitur nga ana jone eshte ne perputhje me prevetivin e punimeve, kohen e realizimit dhe distancen e objektit pasi sipas QKB selia e shoqerise tone ndodhet ne qytetin e Beratit. (5 km larg nga objekti ne te cilen do te kryhen punimet).

Nga sa mesiperperm pergjigjemi ne kohe per cdo problem qe mund te dale gjate ekzekutimit te kontrates ne menyren me te shpejt dhe efikase dhe pa kosto. Nga sa me lart oferta e renditur ne vend te pare duhet te skualifikohet pasi eshte ne kundërshtim me nenin 56 te LPP.

Kërkojmë që procedura e prokurimit mesiperperm te rivleresohet duke kualifikuar si ofertë te vlefshme oferten e ofertuesit Totila sh.p.k. me 4 261 348 leke pa tvsh. Ne si shoqëri serioze ne treg kerkojme drejtesi nga ana juaj pasi kemi nje aktivitet me shume se 20 vjecar ne trgun e punimve te ndertimit dhe nepermjet firmes sone kemi te punesuar nje numer te konsiderueshem punonjesish te cilet kane vetem kete pune si te ardhur financiare. Ne rastin se ankesa jone nuk merret parasysht do ti drejtohem KPP per shqyrtimin e parregullsive dhe deri ne Gjykate kompetente per shqyrtimin e ceshtjes.

II.5. Me shkresën nr. 1494/2 prot., datë 03.09.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes duke mos e pranuar ankesën. Konkretisht, autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes së ankesës argumenton se:

[...]

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave pasi verifikoi dokumentet e tenderit, procesverbalin e hapjes dhe shqyrtimit te ofertave mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, kerkesen per informacion mbi oferten anomalisht te ulet, kthim pergjigje te kerkeses per informacion mbi ofertan anomalisht te ulet te ofertuesve "Eril B&B" shpk dhe "Adriatik" shpk, si dhe ankesen e paraqitur nga ofertuesi "Totila" shpk, per kete procedure prokurimi, arsyeton si me poshte:

Komisioni i Vleresimit te Ofertave nga gjenerimi i renditjes perfundimtare ne sistemin e prokurimit elektronik ka konstatuar se oferta ekonomike e dorezuar nga Bashkimi i Operatoreve Ekonomik (BOE) "Eril B&B" SHPK dhe Adriatik SHPK, perkatesisht me vlere te ofertuar 3,650,000 leke pa TVSH, rezulton, oferte anomalisht e ulet. Per kete arsye bazuar ne ligjin nr 9643 date 20.11.2006

"Per prokurimin publik" neni 56 pika 1 "Per oferten anomalisht te ulet" percaktohet: "Kur autoriteti kontraktor veren se nje ose me shume oferta per kontratat e mallrave, puneve apo sherbimeve, jane anomalisht te uleta, ai, perpara se t'i kualifikoje ato, kerkon me shkrim shpjegime per elemente te vecanta te ofertes". Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka derguar elektronikisht dhe ne rruge postare, per BOE "Eril B&B" SHPK dhe Adriatik SHPK, shkresen nr prot 1448 date 19.08.2019, me lende "Kerkes per informacion mbi oferten anomalisht te ulet". Ne shkrese, kerkohen sqarime, shpjegime per elemente te vecante te ofertes te paraqitura me shkrim, ose ne rruge elektronike, brenda 3 (tre) diteve pune, per konkretisht:

- Anen ekonomike te metodes se ndertimit, procesit te prodhimit ose te sherbimeve te ofruara;*
- Zgjidhjet teknik te ofruara dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem, qe ka ofertuesi per kryerjen e punimeve, per furnizimin e mallrave apo te sherbimeve;*
- Origjinalitetin e puneve, mallrave apo te sherbimeve, te propozuara nga ofertuesi;*
- Zbatueshmerine e detyrimeve, qe lidhen me mbrojtjen ne pune dhe kushtet e punes, ne vendin ku do te kryhet puna, sherbimi apo ku do te sigurohet furnizimi;*

Ofertuesit e BOE "Eril B&B" SHPK dhe Adriatik SHPK brenda afatit kohor te percaktuar, kane kthyer pergjigje me shkrim me shkresen nr. 1448/1 date 21.08.2019 ku kane shpjeguar elementet e vecante te ofertes anomalisht te ulet, si me poshte:

a) Anen ekonomike te procesit te fabrikimit ose prodhimit, qe konsiston ne: Kompania ka ofertuar duke marre per baze cmimet e tregut per secilin ze te preventivit. Gjithashtu kane hartuar koston tekniko-ekonomike per realizimin e objektit.

b) Zgjidhjet teknike te ofruara dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem, qe ju keni per furnizimin e mallrave apo te sherbimeve, qe konsiston ne: Vlera e ofertes eshte bazuar ne cmimet e manualeve me VKM nr 629 date 15.07.2015 per punimet e ndertimit ku perfshihen elemente e koston; Fuqi puntore e kualifikuar sipas specialiteteve edhe me deshmi kualifikimi duke dhene rendiment pune; Shpenzimet e transportit jane minimale; Zgjedhja e materialeve me cilesi dhe me cmimin me te ulet te mundshem; Disa nga materialet e perfshira ne zera e punimeve jane ne gjendje stoku; Te gjitha produktet e ndertimit do te merren ne tregun vendas dhe nga kompani te licensuara per tregtimin dhe prodhimin e materialeve te ndertimit.

c) Origjinalitetin e mallrave apo te sherbimeve, te propozuara nga ana juaj qe konsiston ne: Realizimi i punimeve te ngiashme dhe pervoja e fituar nder vite ne origjinalitet te puneve dhe te sherbimeve

d) Zbatueshmerine e detyrimeve qe lidhen me mbrojtjen ne pune dhe kushtet e punes ne vendin ku do te kryhet sherbimi apo ku do te sigurohet furnizimi qe konsiston ne: Zbatimin e masave te sigurimit teknik te mbrojtjes se punonjesve dhe te kantierit te ndertimit ne zbatim te legjislacionit per sigurine ne kantier. Eksperienca e bashkimit te operatoreve ekonomik ne fushen e ndertimit.

Ofertuesi ka bashkelidhur ne shkresen e tij "Kthim pergjigje per informacionin mbi oferten e ndertimit anomalisht te ulet": Analize teknike per zerin e punimeve (punetor, transport, makineri, material, shpenzim, fitim) dhe fatura tatimore

Duke gene se oferta ekonomike e paraqitur eshte argumentuar nga ofertuesit e BOE "Eril B&B" SHPK dhe "Adriatik" SHPK per te gjitha elementet e vecante, te anes ekonomike te mallrave te ofruara, zgjidhjet teknike, origjinalitetit te mallrave dhe zbatueshmeria e detyrimeve, ne perputhje

me ligjin, krijohet bindja se oferta e paraqitur eshte konform parashikimeve ligjore me te gjitha elementet e saj, dhe si e tille, pranohet si e rregullt.

Per arsyet e me siperme, pretendimi i ofertuesit "Totila" SHPK nuk pranohet. Sa me siper, ju bejme me dije se kunder vendimit te organit qendror bleres mund te behet ankim ne Komisionin e Prokurimit Publik, ne perputhje me nenin 63, pika 6, te LPP.

II.6. Në datën 09.09.2019, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kundërshtuar kualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Eril B&B” sh.p.k. & “Adriatik” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht operatori ekonomik ankimues pretendon se::

[...]

Shoqeria TOTILA SHPK, pasi eshte njohur me njoftimin e kontrates, ne sistemin elektronik te App-se, per procedure e prokurimit me objekt: "Mirembajtja e objekteve ndertimore ne Spitalin Rajonal Berat", e planifikuar per tu zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor Agjencia e Blerjeve te Perqendruara, me date 16.08.2019, me nr reference te procedures: REF-32766-08-05-2019, me fond limit: 5 333 347 (pese milion e treqind e tridhjetë e tremije e treqind e dyzet e shtate) leke pa Tvsh, ka pergatitur dhe ka ngarkuar 1 oferte te suksesshme per procedure ne fjale ne J.V. me Shoqerine RAFIN COMPANY SHPK. Pasi eshte mbylluar afati i dorezimit te ofertave, kemi qene ne pritje te njoftimit te vleresimit nga ana e KVO, dhe me date 22.08.2019, ora 13:50 kemi marre pergjigje per kualifikimin, ku jemi kualifikuar i dyti ne renditje. Nga njoftimi elektronik vihet re se nga ana e Autoritetit Kontraktor (KVO) Agjencia e Blerjeve te Perqendruara, jane kualifikuar 4 Shoqeri (ofertues) dhe Ishogeri (ofertues) eshte skualifikuar

I permendim si me poshte:

- 1. ERIL B&B - 3,650,000 (KUALIFIKUAR);*
- 2. MODESTE - 3,874,259.72 (REFUZUAR OFERTA)*
- 3. TOTILA - 4,261,348 (KUALIFIKUAR)*
- 4. MENI - 4,506,060 (KUALIFIKUAR)*
- 5. ED KONSTRUKSION - 5,113,842 (KUALIFIKUAR)*

Verejme se nga ana e KVO-se eshte bere nje vleresim ne menyre siperfaqsore dhe jo ne perputhje me krieteret e vendosura dhe per kete arsye kemi paraqitur ankese per vlersimin e dhene prane Autoritetit Kontraktor Agjencia e Blerjeve te Perqendruara, dhe kemi marre pergjigje per kete ankimim nepermjet email si dhe me poste me date 06.09.2019, ku na eshte bere e ditur se ankimimi jone nuk eshte marre parasysh nga ana e Autoritetit Kontraktor, edhe pse e pranojne qe oferta ekonomike eshte anomalisht e ulet dhe duhet ta kishin skualifikuar ge ne momentin e vlersimit, perseri e kane kualifikuar dhe ri-kualifikuar. Sa me siper ky vlersim na duket i padrejte dhe duke qene qe jemi kualifikuar i dyti ne renditje, nga ky vleresim cenohet oferta jone dhe interesi i kesaj shoqerie. Duke na hequr te drejten e te qenurit oferta e sukseshme per realizimin e kesaj kontrate e kualifikuar si e para. Analizojme si me poshte:

1. Per shoqerine ERIL B&B sh.p.k, operatori i kualifikuar si i pari ne renditje, shprehim rezervat tona si me poshte:

- Mendojme qe oferta e operatori ekonomik ERIL B&B sh.p.k nuk eshte e sakte dhe nuk eshte ne perputhje me legjislacionin e prokurimit publik ne fuqi. Per sa i perket vleresimit nuk jemi dakord pasi nuk jane zbatuar udhezimet perkatese nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, pasi eshte ne

shkelje te ligjit nr9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar dhe VKM nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", nenit 56 te LPP.

"1. Kur autoriteti kontraktor veren se nje ose me shume oferta per kontratat e mallrave, puneve apo sherbimeve jane anomalisht te uleta, ai, perpara se te vazhdoje me procesin e vleresimit te ofertave, i kerkon operatorit ekonomik perkates te paraqese me shkrim dhe brenda 3 diteve pune shpjegime per elemente te vecanta te ofertes, per:

- a) anen ekonomike te metodet se ndertimit, procesit te prodhimit ose te sherbimeve te ofruara,
- b) zgjidhjet teknik te ofruara dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem, qe ka ofertuesi per kryerjen e punimeve, per furnizimin e mallrave apo te sherbimeve
- c) origjinalitetin e puneve, mallrave apo te sherbimeve, te propozuara nga ofertuesi
- c) zbatueshmerine e detyrimeve, qe lidhen me mbrojtjen ne pune dhe kushtet e punes, ne vendin ku do te kryhet puna, sherbimi apo ku do te sigurohet furnizimi

2. Autoriteti kontraktor i verifikon keto elemente duke u keshilluar me ofertuesin dhe ne baze te informacionit te paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzoje oferten, kur edhe pas shqyrtimit te infomacionit te paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo eshte e rregullt ne te gjitha elementet e saj. Duke u nisur nga me lart oferta e renditur ne vend te pare eshte nje oferte e pavlefshme dhe nuk eshte perlllogaritur ne menyren e duhur dhe per me teper komisioni i vleresimit e ka kualifikuar pa te drejte pasi duhet ta skualifikonte nga renditja

- Oferta e operatori ekonomik ERIL B&B shpk nuk permbush parashikimet e nenit 56 te LPP. Eshte nje oferte e pabazuar ne VKM nr 629 date 15.07.2015 per punimet e ndertimit ku perfshihen elemente e kostos.

- Mendojme se kostua teknike-ekonomike e ofertes se operatorit ERIL B&B sh.p.k eshte pamjaftueshme per realizimin e objektit te prokurimit.

- Mendojme qe materialet te cilat operatori ekonomik ERIL B&B shpk i ka deklaruar ne gjende stoku, nuk jane verifikuar nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave ne momentin e vleresimit te ofertes nga ky i fundit. Zbatueshmeria e detyrimeve qe rrjedhin nga LPP, VKM dhe Udhezimet perkatese per prokurimin publik ne rastin konkret nuk jane respektuar dhe linden hije dyshimi per vleresimin e kesaj procedure prokurimi. Kemi dyshime te forta qe eshte shkelur LPP pasi nje nga parimet baze te keti ligji jane:

- a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabarte i ofertuesve ose kandidateve;
- b) transparence ne procedurat e prokurimit
- c) barazi ne trajtimin e kerkesave dhe te detyrimeve, qe u ngarkohen ofertuesve ose kandidateve.

Nisur nga tipologjia e objektit e cila shtrihet ne qarkun e Beratit me objekt mirembajtja e Spitalit Rajonal Berat, oferta e paraqitur nga ana jone eshte ne perputhje me prevetivin e punimeve, Kohen e realizimit dhe distance e objektit pasi sic vihet re edhe nga QKB selia e shoqerise tone ndodhet ne qytetit e Beratit. (5 km larg nga objekti ne te cilen do te kryhen punimet)

Nga sa mesiperme pergjigjemi ne kohe per cdo problem qe mund te dale gjate ekzekutimit te kontrates ne menyren me te shpejt dhe efikase dhe pa kosto. Shoqeria TOTILA Shpk eshte nje subjekt serioz ne treg ndaj edhe kerkojme drejtesi ana juaj pasi kemi nje aktivitet me shume se 20 vjecar ne tregun e punimeve te ndertimit nepermjet firmes sone kemi te punesuar nje numer te konsiderueshem punonjesish te cilet kane vetem kete pune si te ardhur finaciare ne familjet e tyre. Eshte e drejta jone legjitime per te kerkuar te gjitha te drejtat qe na ngarkon legjislacioni ne fuqi

per prokurimin publik. Sa me siper kerkoime skualifikimin e operatori ekonomik ERIL B&B shpk, si dhe kualifikimin e operatori tone ekonomik si oferte e sukseshme dhe si operatori qe permbush te gjitha kriteret e vendosura.

Eshte bere ankese sipas formularit te ankeses prane Autoritetit Kontraktor me shkim dorezuar ne poste dhe kemi marre pergjigje per kete ankese ne email dhe me poste ne date 06.09.2019.

Kërkojmë skualifikimin e operatorit ekonomik Eril B&B sh.p.k. si dhe kualifikimin e operatorit tonë ekonomik si oferte e sukseshme dhe si operatori qe permbush te gjitha kriteret e vendosura.

II.7. Në datën 24.09.2019, nëpërmjet shkresës me nr.1599/1 prot., datë 23.09.2019, me objekt: “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit “Mirëmbajtje e objekteve ndërtimore në Spitalin Rajonal Berat”, si dhe në datën 07.11.2019, nëpërmjet shkresës me nr.1599/4 prot., datë 04.11.2019, me objekt: “Plotësim dokumentacioni për procedurën e prokurimit “Mirëmbajtje e objekteve ndërtimore në Spitalin Rajonal Berat” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Totila” sh.p.k. & “Rafin Company” sh.p.k.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Totila” sh.p.k. & “Rafin Company” sh.p.k. për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Eril B&B” sh.p.k. & “Adriatik” sh.p.k. si ofertë anomalisht e ulët, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 10 “Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit”, zërat e punimeve si më poshtë vijon:

<i>Tabela e vecante – SPITALI RAJONAL BERAT</i>				
<i>NR.</i>	<i>Nr. analize</i>	<i>Emërtimi I punimeve</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia e pritshme për 24 muaj</i>
		<i>Punime dheu</i>		
1	2.1	8'	<i>m3</i>	17
2	2.37/5b	<i>Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km</i>	<i>m3</i>	18
		<i>Punime murature guri</i>		
2	2.52/2	<i>Mur guri themel e xokol me llaç perzier M 25</i>	<i>m3</i>	4.5
4	2.54/2	<i>Mur guri ne lartesi deri 3m me llaç çimento M 25</i>	<i>m3</i>	4

		<i>PUNIME MURATURE TULLE</i>		
2	2.89	<i>Mur me blloqe betoni t=15cm deri 3m me llaç perzier M 15</i>	<i>m3</i>	6
2	2.64/1	<i>Mur me tulle plota ne lartesi deri 3m me llaç perzier M 15</i>	<i>m3</i>	4
3	2.71/1	<i>Mur me tulle te lehtesuara dopio deri 8m me llaç perzier M15</i>	<i>m3</i>	3.6
		<i>Punime hekur betoni</i>		
1	2.166	<i>F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm</i>	<i>ton</i>	0.04
2	2.182	<i>Konstruksione metalike te thjeshta</i>	<i>ton</i>	0.1
		<i>Punime h / izolimi dhe çatie</i>		
3	2.197	<i>Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k katrama</i>	<i>m2</i>	190
4	2.200	<i>Shtrese lluster cemento 1:2, t = 20 mm</i>	<i>m2</i>	190
5	2.209	<i>Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 mm</i>	<i>ml</i>	75
7	2.206	<i>Kasete shkarkimi me llamarine xingat</i>	<i>cope</i>	4
8	2.209/a	<i>Ulluk shkarkimi vertikal me PVC Ø 120mm</i>	<i>ml</i>	78
9	2.239/a	<i>Shtrese termoizoluse me polisterol t=10cm</i>	<i>m2</i>	30
		<i>Punime shtresash</i>		
7	2.291	<i>Bordura trotuari 25x12cm te derdhura ne vend</i>	<i>ml</i>	24
8	2.267/1	<i>Shtrese me pllaka porcelanat importi</i>	<i>m2</i>	48
	2.273/5	<i>Shtrese me pllaka mermeri t=3cm</i>	<i>m2</i>	7.6
7	3.620	<i>Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka</i>	<i>m2</i>	80
		<i>Punime tavani e suvatimi</i>		
1	2.310	<i>Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25</i>	<i>m2</i>	90
3	2.324/b	<i>Plintuse grez importi, h = 10 cm</i>	<i>ml</i>	42
		<i>Punime suvatimi e veshje me pllaka</i>		
1	2.326	<i>Veshje me pllake majolike</i>	<i>m2</i>	60
2	2.328	<i>Patinim muri allçi (stuko)</i>	<i>m2</i>	100
3	2.330	<i>Patinim tavani allçi (stuko)</i>	<i>m2</i>	48
4	2.331	<i>Suva e zakonshme fasade mur tulle h ~ 8 m</i>	<i>m2</i>	70
5	2.334	<i>Suva e zakonshme fasade mur tulle lartesi mbi 8 m</i>	<i>m2</i>	16
7	2.350	<i>Suva xokoli me granil e çimento te zakonshme me spruco</i>	<i>m2</i>	36
10	2.358/d	<i>Veshje muri me kartonxhes cimentato</i>	<i>m2</i>	40
11	2.308/a	<i>Suvatim me grafiato h > 4 m</i>	<i>m2</i>	100
9	2.358/c	<i>Veshje muri brenda me polisterol te thjeshte t=5cm + rrjete + suva.</i>	<i>m2</i>	40
		<i>Punime dyer dhe dritare</i>		

4	2.395/a	Dere d/alumini pa xham, me mbushje d/a.	m2	3.6
5	2.395/a	Dyer d/alumini dopio xham.	m2	3.6
7	2.383/1	F.V dyer te brendeshme druri importi cilesi e I-re.	m2	12
	2.386/2	Dyer te blinduara importi	m2	4
		Punime bojatisje		
1	2.399	Sherbetisje e bojatisje me gelqere	m2	100
2	2.400	Boje vaji siperfaqe druri	m2	80
3	2.403	Boje vaji mbi siperfaqe te patinuar	m2	320
5	2.404/1	Boji hidroplastike importi silsia e I pare	m2	940
		Punime te ndryshme dhe prishje		
1	2.426/1	Prishje mur tulle me pastrim	m3	16
2	2.426/3	Prishje shtresa betoni	m3	18
		Punime germimi		
1	3.17	Germime dheu ne seksion te lire me krahe, ne toke te bute, kateg. I-II, pa hedhje	m3	3
2	3.46/1	Germim kanalesh ne toke te forte, me krahe, me seksion deri 0.75 m ²	m3	4
3	3.139	Germim dheu me ekskavator goma 0.35~0.40m ³ , ne themele, toke zak, kat III, me shkarkim ne toke	m3	3.6
		Punime shtresash		
1	3.193/c	Shtrese zhavor lumi t=30cm, me cilindrim	m2	40
3	3.201	Cilindrim shtrese çakelli t=10cm, me rul	m2	28
		Punime asfaltimi		
	3.207	Shtrese cakulli me t-10 perhapur ngjeshur me makine	m2	36
1	3.204/1	Cilindrim shtrese çakelli t>5cm, per asfaltim	m2	36
2	3.222	Shtrese binderi me granil guri kave, 5cm, me krah	m2	36
3	An	Sperkatje me emulsion bituminoz 1 l/m2	m2	36
4	3.226	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me krah	m2	36
		Punime betoni		
	2.576	Puse kontrolli 1.25x1.25x1,5m	cope	2
	2.576	Puse kontrolli 1.5x1.5x1,5m	cope	2
	An - 18	Pusete shkarkimi b/a, 50 x 50 cm, h = 100 cm	cope	2
	An - 22	Pusete b/a shiu 40 x 40 cm, h = 100 cm, me kapak zgare hekuri	cope	2
	An - 22/1	Pusete b/a shiu 40 x 40, h = 100 cm, me kapak gize	cope	2
6	3.243	Struktura monolite betoni C 16/20	m3	4

7	3.243/1	Struktura te holla monolite betoni C 16/20	m3	2.4
		Punime te ndryshme		
1	An	F.V. Xham I Bardhe	m2	23
2	An	F.V. Xham Qorr	m2	14
3	An	F.V. Brava dyer duralumini	cope	28
4	An	F.V. Brava dyer duralumini plastike	cope	8
5	An	F.V. Fishek brave dyer duralumini	cope	15
6	An	F.V. Doreza duralumini	cope	12
7	An	F.V.Brave Dere druri ose e Blinduar	cope	6
8	An	F.V.Fishek Dere druri ose e blinduar	cope	18
9	An	F.V.Celes Sirtari	cope	6
10	An	F.V.Mentesha Derealumini	cope	23
11	An	F.V.Mentesha kanata Dollapesh	cope	15
12	An	F.V.Mentesha kanata Komodinash	cope	36
13	An	F.V.Vida Stolash	cope	82
14	An	Upa + vida fi 10	kuti	4
15	An	Upa + Vida per kaloriferet e kaldajes fi 12	cope	25
		Punime elektrike		
1	480/2	F.V tub plastmasi Ø 18 ~ 21 mm	ml	40
4	2.483	F.V Çelesa e priza 10 A	cope	12
5	2.485	F.V Çelesa e priza 10 A me nulifikim	cope	12
6	2.486	F.V Portollampa normale 10 A	cope	22
7	2.487	F.V Kutiderivacioni plastike	cope	8
10	2.487/c	F.V kuti suport pllaket 2 modular	cope	8
11	2.487/d	F.V kuti suport pllaket 4 modular	cope	8
13	2.485/d	F.V priza shuko	cope	15
15	2.485/2	F.V Çeles 1 polar 220V 10A "	cope	15
22	2.490/1 a	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 10A	cope	6
23	2.490/1 b	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A	cope	6
24	2.490/1 c	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 32A	cope	4
	2.490/1 d	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 40A	cope	4
27	2. a- 100	Çeles me dy pozicione, I-0-2 380V,20A	cope	15
28	2. a- 101	Çeles automat termo-elektro magnetik 2P;20A;220V	cope	4
31	2. a- 130	Ndricues tip plafoniere ,me llampe fluoreshente 40ë,	cope	2

32	2. a-131	Ndricules tip plafoniere, emergjence, 1x18ë, IP65	cope	2
33	2. a-132	Ndricules tavanor fluoreshente 1x40ë	cope	2
34	2. a-133	Ndricules tavanor fluoreshente 1x18ë	cope	2
35	2. a-134	Ndricules plafoniere brace 1x40ë	cope	2
36	2. a-135	Ndricules tip spot me llampa fluoreshente, 2x18ë	cope	2
37	2. a-136	Ndricules pllafonier muror 1x60ë	cope	2
42	An	F.V.Llampe floureshente T 8 18ë 220 -240 V 60 cm	cope	167
43	An	F.V.Llampe ekonomike Led	cope	150
44	An	F.V.Llampn floreshente TLD 36ë/54 CE 120 cm	cope	170
45	An	F.V.Starte	cope	130
46	An	F.V.Droze	cope	32
47	An	Llampa per ndricuesit e lulishtes tek Arshiva	cope	21
48	An	Llampa per Prozhektoret	cope	10
49	An	Llampa per Prozhektoret Led per shtyllat e ndricimit jashte	cope	10
50	An	Rezistence dushi	cope	6
51	An	Termostat Dushi	cope	6
52	AN	F.V percjelles 3 x 1.5 mm ²	ml	100
		Punime h /sanitar e		
2	2.492	F.V tub xingato dhe rakorderi Ø > 1 "	kg	50
5	2.495	F.V lavaman porcelani importi me mishelator	cope	2
8	2.501	F.V ËC allafrenga importi	cope	2
9	2.504	F.V ËC allaturka importi	cope	2
15	2.514	F.V pilete dysHEMEJE Ø 40 mm	cope	6
26	An - 9	F.V Saraçineske PPR 1/2"	cope	10
27	An - 10	F.V Saraçineske PPR 3/4"	cope	4
28	An - 15	F V bolier 80 liter, uje te ngrohte	cope	2
29	An - 16	F V bolier 12 liter, uje te ngrohte sanitar	cope	4
31	2.516/1	F.V Tuba e rakorderi PVC	kg	40
32	An	F.V.Rubinet me leve	cope	24
33	An	F.V.Kundravalvul 1/2	cope	30
34	An	F.V.Gomina 40/32	cope	10
35	An	F.V.Kartush grupi	cope	20
36	An	F.V.Galixhan 1/2	cope	10

37	An	F.V.Galixhan 3/8	cope	2
38	An	F.V.Tub Fresibel 1/2 40 cm	cope	30
39	An	F.V.Tub Fresibel 1/2 50 cm	cope	44
40	An	F.V.Tub Fresibel 1/2 80 cm	cope	16
41	An	F.V.Tapa xingato 1/2	cope	24
43	An	F.V.Sifon Lavamani	cope	37
44	An	F.V.Ventil 1/2	cope	24
45	An	F.V.Grup Lavamani	cope	4
46	An	F.V.Mekanizem Shkarkimi	cope	7
47	An	F.V.Grup dushi	cope	6
48	An	F.V.Zorre dushi	cope	15
49	An	F.V.Koke Dushi	cope	13
50	An	F.V.Kasete ËC	cope	4
51	An	F.V.Kapak ËC	cope	6
52	An	F.V.Pasqyre komplet	cope	3
54	An	Silikon	cope	9
55	An	Sprajt me ngjyra te Ndryshme	cope	11

III.1.2. Gjithashtu, në shtojcën 8 “Specifikimet teknike”, të dokumentave të tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shtrese betoni

Shtresat e betonit do te jene te markave C 16/10 per pjesen e shtrimit te shtresave te betonit dhe C 16/10 per pjesen e betoneve strukturore.

Prishje mur tulle me pastrim

Prishje shtresa betoni

Prishja e murit dhe betonit do te behet me matrapik duke u munduar sa me shume te eliminohen zhurmat e teperta dhe pluhurat.

Ngarkimi i materialeve inerte do te behet direkt ne Kamion dhe transportimi i tyre jashte territorit te Spitalit.

Suva e zakonshme fasade mur tulle h ~ 8 m dhe suva brenda mur tulle h-4m me krahe

Muret qe do te suvatohen , me pare do te leshohet nje spruce me llac cimentoje per nje ngjitje te shtresave te tjera te suvase me muret dhe soletat. Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaçi bastard m-25 me përmbajtje për m²: rërë e larë 0,005 m³; llaç gëlqereje m- 1: 2, 0.03 m³; çimento 400, 6.6 kg; ujë, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shirtit me llaç me trashësi 15 cm çdo 1 deri në 1,5 m), dhe e lëmuar me mistri e bërda, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

SHTRESE ME PLLAKE GRES

Pllakat duhen zgjedhur për secilin ambient, duke marrë parasysh nevojat dhe kriteret, që ato duhet t'i përmbushin. Për sallen e maternitetit dhe meremetimet ku janë thyer duhet që pllakat të jenë të Klasës V , me sipërfaqe të ashpër, në mënyrë që të sigurojnë një ecje të sigurtë pa rrëshqitje.

Në ambientet me lagështirë (ËC, banjo e dushe) duhet të vendosen pllaka të klasës I, që e kanë koeficientin e marrjes së ujit < 3 %.

Për këtë duhet që përpara fillimit të punës, kontraktori të paraqesë tek Supervizori disa shembuj pllakash, së bashku me certifikatën e tyre të prodhimit dhe vetëm pas aprovimit nga ana e tij për shtrimin e tyre, sipas kushteve teknike dhe rekomandimeve të dhëna nga prodhuesi.

VESHJE ME PLLAKA

Pllakat duhen zgjedhur për secilin ambient, duke marrë parasysh nevojat dhe kriteret, që ato duhet t'i përmbushin. Për shkolla dhe kopshte, duhet që pllakat të jenë të Klasës V , me sipërfaqe të ashpër, në mënyrë që të sigurojnë një ecje të sigurtë pa rrëshqitje. Në ambientet me lagështirë (ËC, banjo e dushe) duhet të vendosen pllaka të klasës I, që e kanë koeficientin e marrjes së ujit < 3 %. Për këtë duhet që përpara fillimit të punës, kontraktori të paraqesë tek Supervizori disa shembuj pllakash, së bashku me certifikatën e tyre të prodhimit dhe vetëm pas aprovimit nga ana e tij për shtrimin e tyre, sipas kushteve teknike dhe rekomandimeve të dhëna nga prodhuesi.

HIDROIZOLIMI

Per tarracat duhet qe te krijohen me pare pjerresite e nevojshme per kullimin e ujrave ne min 2.5%, dhe drejtimi i ujrave per ne kollonat e shkarkimint, dhe kollonat nuk duhet te mbledhin ujra per nje siperfaqe me te madhe se 75m2. Pjerresite mund te behen me izobeton dhe pastaj duhet te vendosen shtresat perkatese te llustres se cementos , H/Izolimit etj.

LYERJA

Lyerja do te jete per ambjentet e brendeshme me boje hidroplastiko dhe jo te patinuara ne menyre qe te mos pengohet ventilimi natyral I mureve, dhomat e pacienteve e personelit do te jene te lyera me boje hidroplastiko cilesia e pare.

Lyerja e siperfaqeve metalike shkalleve te hyrjes se emergjences te behen me boje zmalto te zeze.

Lyerja e siperfaqeve te drurit stolat e Poliklinikes, dyert e Infektivit e te hyrjes tek shkallet e emergjences te behen me boje zmalto kafe.

Lyerja e korridorreve te Poliklinikes se Specialiteteve me boje vaji ne siperfaqe te patinuar te behet me ngjyre jeshile.

Tubat e sistemit të furnizimit me ujë të pastër

Për sistemin e furnizimit me ujë të ndërtesave mund të përdoren tuba plastike PPR (Polipropilen) që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë sipas standartit ISO 9001 ose mund të përdoren tuba xingato që janë konform standarteve të mësipërme për cilësinë dhe testimin e tyre. Theksojmë se tubat prej PPR janë afro 15 herë më të lehtë se tubat e çelikut.

9.2.2 Rakorderitë për tubat e ujit të pijshëm

Për sistemin e furnizimit me ujë të ndërtesave, në rastet kur do të përdoren tuba plastike PPR (Polipropilen Random), rakorderitë përkatëse duhet të jenë PPR të cilat plotësojnë kërkesat e cilësisë sipas standartit ISO 9001 ndërsa në tubat xingato rakorderitë janë xingatoje.

9.2.3 Saraçineskat për ujin e pijshëm

Saraçineskat janë pajisje të veçanta që do të përdoren për kontrollin e rrjedhjes në tubacionet e ujit. Me anë të saraçineskave mund të ndryshohet madhësia e prurjes që i jepet pjesës tjetër të tubit ose ndërprerjen e plotë të rrjedhjes. Saraçineskat mund të jenë me material bronxi, gize ose PPR. Ato janë të tipit me sferë ose me porte, me bashkim, me filetim ose me fllanxa.

Saraçineskat sipas mënyrës së bashkimit me tubat I ndajmë në lloje: me fllanxhë dhe me fileto.

9.3.1 Tubat e shkarkimit

Për shkarkimet e ujrave do të përdoren tuba plastike PVC që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë.

9.3.2 Rakorderitë për tubat e shkarkimit të ujrave

Për lidhjen e tubave të shkarkimit me njëri tjetrin si dhe me pajisjet sanitare apo grupet e tyre do të përdoren rakorderitë përkatëse me material plastik PVC, që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë.

9.5.1 ËC dhe kaseta e shkarkimit

Në ambientet e larjes apo dhomat e tualetit parashikohet edhe vendosja e ËC-ve. Ato janë me material porcelani me të dhënat e standarteve teknike ndërkombëtare dhe duhet të përcaktohen në projekt nga projektuesi. Ato mund të jenë të tipit oriental ose alla frënga. Në shkolla rekomandohen të tipit oriental ËC, ku vendoset direkt në dysheme dhe montohet llaç çimento sipas udhëzimeve të dhëna nga supervizori.

ËC tip alla frënga përdoren në kopshte dhe për personelin pedagogjik dhe antikapatët, fiksohen në dysheme ose në mur me fasheta tunxhi, vida dhe tapa me fileto pa ndërprerë veshjen me pllaka të murit. Para fiksimit të tyre duhet të bëhet bashkimi me tubat e shkarkimit të ujrave. ËC mund të jetë me dalje nga poshtë trupit të saj ose me dalje anësore në pjesën e pasme të ËC. Në ËC me dalje anësore tubi i daljes duhet të jetë në lartësinë 19 cm nga dyshemeja.

9.5.4 Lavamanet

Në ambientet e larjes apo dhomat e tualetit, gjithmonë duhet të parashikohen pajisjet hidrosanitare përkatëse (lavamanet) të cilat shërbejnë si vende për larjen e duarve dhe fytyrës së fëmijëve. Lavamanet mund të jenë metalike, porcelani, muri tulle i suvatuar e veshur me pllaka ose të montuar në vepër. Lloji i materialit përbërës të tyre duhet të përcaktohet në projekt nga projektuesi.

Lavamanët duhet të sigurojnë përcjellshmëri të lartë të ujrave, rezistencë ndaj goditjeve mekanike, mbrojtje izoluese ndaj ujrave, eliminim të zhurmave gjatë punës, rezistencë ndaj korrozionit dhe agjentëve kimike, lehtësi gjatë punës në to dhe mundësi të thjeshta riparimi.

Lavamanet e porcelanit dhe mbështetësja e tyre fiksohen në mur me fasheta tunxhi, vida dhe tapa me fileto pa ndërprerë veshjen me pllaka të murit. Pas fiksimit të saj në mur duhet të bëhet vendosja e rubinetave me tunxh të kromuar mbi lavaman dhe bashkimi i lavamanit me tubat e kanalizimit të sifonit dhe tubat e shkarkimit të ujrave. Njëkohësisht lavamani duhet të pajiset edhe me piletën e tij metalike. Pileta duhet të vendoset në pjesën më të ulët të sipërfaqes së gropës mbledhëse ku është hapur një vrimë me përmasat e piletës. Lavamani ka një gropë mbledhëse me përmasa 40/60 x 36-45 cm në varësi të llojit dhe modelit të zgjedhur. Përmasat e lavamanit janë në varësi të llojit dhe modelit të tyre Lavamanet vendosen në lartësi 75- 85 cm sipas kërkesës së projektit dhe Supervizorit. Distanca horizontale e vendosjes së tyre nga pajisjet e tjera hidrosanitare (bide, ËC, etj) duhet të jetë të paktën 30 cm

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve “Eril B&B” sh.p.k. & “Adriatik” sh.p.k., rezulton se, është paraqitur dokumenti me emërtimin Kontratë Bashkëpunimi, ndërmjet shoqërisë “Eril B&B” sh.p.k. dhe shoqërisë “Adriatik” sh.p.k., nga ku shoqëria “Eril B&B” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 50 % të vlerave të zërave të punimeve të preventivit dhe shoqëria “Adriatik” sh.p.k. 50% të vlerave të zërave të punimeve të preventivit, shoqëruar dhe me Preventivin e punimeve të ndarë sipas përqindjes së pjesëmarrjes së secilit operator.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “Eril B&B” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.3.9. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”*. Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”,* ndërsa në pikën 3 parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”*.

III.1.4. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e zërave të marra përsipër.

III.1.5. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”*

III.1.6. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se “[...]

1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas

shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

III.1.7. Në nenin 66, pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlogaritur.

- Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP-së”.

Sa më sipër referuar, nëse një apo disa oferta vlerësohen anomalisht të ulta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, ku thuhet se:

“1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;

b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;

c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;

ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj”.

III.1.8. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar e tillë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimes duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e

operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetohet zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga LPP, janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezultojnë anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P. gjykon se nga interpretimi i normës së mësipërme lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riksut që mund të sjellë një ofertë e cila rezultojnë anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezultojnë anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga mos kryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezultojnë anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përllogaritjes të parashikuar në ligj.

III.1.9. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Eril B&B” sh.p.k. & “Adriatik” sh.p.k., si edhe nga përllogaritjet e kryera, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, oferta ekonomike në vlerën prej 3.650.000 lekë pa TVSH, në zbatim të nenit 66 pika 5 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, rezultojnë anomalisht e ulët. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se autoriteti kontraktor ka vepruar drejt kur gjatë periudhës së vlerësimit të ofertave i ka kërkuar informacion të detajuar bashkimit të operatorëve ekonomikë “Eril B&B” sh.p.k. & “Adriatik” sh.p.k. në zbatim të nenit 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Nga verifikimi dhe shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor të depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezultojnë se në datën 19.08.2019, me anë të shkresës nr.1448 prot., autoriteti kontraktor i ka kërkuar bashkimit të operatorëve ekonomikë “Eril B&B” sh.p.k. & “Adriatik” sh.p.k. informacion mbi ofertën anomalisht të ulët, sipas të cilës është kërkuar (citojmë) “[...] ju njoftojmë se gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është konstatuar se oferta e paraqitur nga ana juaj rezultojnë anomalisht e ulët. Përpara se të vazhdojmë me procesin e vlerësimit të ofertave, ju

kërkojmë të paraqisni me shkrim/në rrugë elektronike dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për element të vecantë të ofertës tuaj për:

a) anen ekonomike te procesit te prodhimit ose te sherbimeve te ofruara; b) zgjidhjet teknik te ofruara dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem, qe Ju keni per furnizimin e mallrave apo te sherbimeve; c) origjinalitetin e mallrave apo te sherbimeve, te propozuara nga ana juaj; c) zbatueshmerine e detyrimeve, qe lidhen me mbrojtjen ne pune dhe kushtet e punes, ne vendin ku do te kryhet sherbimi apo ku do te sigurohet furnizimi. Po ashtu, ju njoftojme se keni detyrimin te argumentoni dhe te dokumentoni me prova shkresore sqarimet per elementin/elementet e vecanta te ofertes, ne perputhje me kerkesat e nenit 56 te LPP. Autoriteti kontraktor do t' i verifikojte keto elemente dhe ne baze te informacionit te paraqitur nga ana juaj, mund ta pranoje oferten ose mund ta refuzojte ate, nese pas shqyrtimit te infomacionit te paraqitur nga ana juaj nuk bindet se ajo eshte e rregullt ne te gjitha elemente e saj. [...]”.

III.1.10. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga autoriteti kontraktor konstatohet se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eril B&B” sh.p.k. & “Adriatik” sh.p.k., ka paraqitur në datën 21.08.2019, protokolluar me nr. 1448/1 prot., nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (shoqëruar edhe me kartelën përkatëse të autoritetit kontraktor), shkresën me objekt “*Kthim përgjigje kërkesës për informacion mbi Ofertën Anomalisht të Ulët*” e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Eril B&B” sh.p.k. & “Adriatik” sh.p.k., në të cilën ka paraqitur një përshkrim dhe interpretim narrativ të ofertës së tij.

III.1.11. Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga autoriteti kontraktor konstatohet se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eril B&B” sh.p.k. & “Adriatik” sh.p.k., për argumentimin e ofertës së tij si ofertë anomalisht e ulët, ka paraqitur tabelë “Analiza teknike për zërin e punimeve” për disa zëra, si dhe Faturë Tatimore Shitje nr.9, datë 15.07.2019, midis shitësit N.S dhe blerësit “Eril B&B” sh.p.k. për blerjen e disa mallrave (cimento; prajmer; zgarë hekuri; hekur ndërtimi; polisterol).

III.1.12. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi dokumentacionin e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eril B&B” sh.p.k. & “Adriatik” sh.p.k. nga ku rezulton se ka paraqitur ofertën ekonomike, e cila rezulton se është anomalisht e ulët dhe, sipas informacionit të autoritetit kontraktor, rezulton se edhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave e ka konstatuar këtë fakt, dhe ka kërkuar që nga operatori ekonomik të paraqitej argumentimi i ofertës në përputhje me përcaktimet e nenit 56 të ligjit për prokurimin publik.

III.1.13. Përpara se të marrë në analizë materialin justifikues/argumentues të operatorit ekonomik bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eril B&B” sh.p.k. & “Adriatik” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson ti referohet edhe praktikës e legjislacionit të BE mbi çështjen. Kështu, në çështjen precedent *Lombardini and Mantovani* (C-285/99 [2001] ECR I-9233), Gjykata Europiane e Drejtësisë (Luksemburg) u shpreh se “*Cilido qoftë legjislacioni, autoritetet kontraktore janë të detyruara të identifikojnë dhe hetojnë Ofertat Anomalisht të Ulëta, pavarësisht nëse ata kanë për qëllim t'i skualifikojnë ato*”. Kjo qasje mbështetet nga fakti se, Komisioni European, ndërsa draftonte Direktivën përkatëse, kishte përpara tij Opinionin e Komitetit Ekonomik e Social të Këshillit European (CES 515/2001), i cili propozonte se: “*Në rast të një oferte anomalisht të ulët ... duhet të specifikohet se autoritetet kontraktore duhet t'i hetojnë ofertat të cilat duken se janë anomalisht të ulëta. Duhet të përcaktohet qartësisht se ofertat në fjalë do të refuzohen nëse nuk do të paraqitet një justifikim i përshtatshëm*”. Ky parashikim është parë nga

këndvështrimi i mbrojtjes së autoriteteve kontraktore nga ofertues që do të fitonin kontrata përmes çmimesh të pambështetura, me rrezik potencial për të rinegociuar fondin limit pak kohë pas lidhjes së kontratës; keqpagimin e punëtorisë apo të nënkontraktorëve, apo përdorimin e materialeve të cilësisë së ulët. Komisioni European ka deklaruar se ky është një problem i hasur posaçërisht në industrinë e ndërtimit (dokumenti “Parandalimi, Zbulimi dhe Përjashtimi i Ofertave Anomalisht të Ulëta në Industrinë Europiane të Ndërtimit” *DG III 5 Qershor 1999*). Një ofertë anomalisht e ulët mund të justifikohet ekonomikisht përmes metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushteve përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar.

III.1.14. Duke u rikthyer në çështjen tonë, nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor rezulton se nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Eril B&B” sh.p.k. & “Adriatik” sh.p.k. me synim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët është dorëzuar dokumenti “*Kthim përgjigje kërkesës për informacion mbi Ofertën Anomalisht të Ulët*”, datë 21.08.2019, protokolluar me nr. 1448/1 prot., nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

III.1.15. Nga verifikimi i këtij dokumentacioni të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eril B&B” sh.p.k. & “Adriatik” sh.p.k. në mbështetje të ofertës së paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, përtej titullit të tij, qartësisht rezulton se dokumentacioni i dorëzuar dhe protokolluar në datën 21.08.2019, pranë autoritetit kontraktor, është thjesht një dokument i shkruar në mënyrë narrative ku është bërë një përshkrim i ofertës së tij dhe është paraqitur një analizë e vetëm disa prej artikujve që kërkohen nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, për realizimin e këtij shërbimi. Gjithashtu, bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur një faturë tatimore, me disa artikuj, të cilët zënë një pjesë shumë të vogël të të gjithë zërave të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Konstatohet se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eril B&B” sh.p.k. & “Adriatik” sh.p.k. ka paraqitur vetëm një analizë të thjeshtë të disa prej artikujve të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit dhe për asnjë rast nuk ka argumentuar se përse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet, pasi operatori ekonomik, bazuar në legjislacionin e sipërcituar, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbështetës apo provues si: fatura tatimore, fletë zhdoganimi, kontrata furnizimi apo kontrata të mëparshme të lidhura me autoritete të ndryshme, apo ndonjë dokument tjetër, që të argumentojë kushtet apo elementët e favorshëm pse kjo ofertë anomalisht e ulët nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës.

III.1.16. Akoma më tej, operatori ekonomik “Eril B&B” sh.p.k. është paraqitur në këtë procedurë prokurimi si një bashkim operatorësh ekonomikë së bashku me operatorin ekonomik “Adriatik” sh.p.k., ku sipas kontratës së bashkëpunimit secili prej tyre do të kryejë 50 % të punimeve. Gjithashtu, bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur, preventivin e punimeve, ku çdo zë do të realizohet 50 % me 50 % nga secili anëtar i bashkimit.

Sa më sipër, duke qenë se zërat e punimeve do të kryhen në mënyrë të barabartë nga të dy anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Eril B&B” sh.p.k. & “Adriatik” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ky i fundit, për të justifikuar ofertën e tij anomalisht të ulët, konstaton se kjo analizë, e cila siç thamë më lart është vetëm një përshkrim narrativ, është paraqitur vetëm për operatorin ekonomik “Eril B&B” sh.p.k., ndërsa për operatorin ekonomik “Adriatik” sh.p.k. nuk është paraqitur asnjë argument apo dokumentacion

provues, për të justifikuar ofertën anomalisht të ulët, për zërat e marrë përsipër, sipas përqindjes së përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit.

Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e zërave të marra përsipër

III.1.17. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomik – oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime të cilat nuk janë të mbështetura në fakte e prova që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: *metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar*), duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

III.1.18. Rrjedhimisht, sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Eril B&B” sh.p.k. & “Adriatik” sh.p.k. nuk është sjellë argumentimi i ofertës anomalisht të ulët në respekt të nenit 56 të LPP-së, ndaj oferta e këtij operatori duhet të ishte skualifikuar nga ana e autoritetit kontraktor.

Komisioni i Prokurimit Publik, ndërsa thekson nevojën e kërimit të dokumentacionit shpjegues/argumentues nga një operator ekonomik oferta e të cilit është identifikuar në bazë të formulës ligjore si anomalisht e ulët, përpara sesa autoriteti kontraktor ta skualifikojë atë, nuk mund të mos tërheqë vëmendjen e autoriteteve kontraktore se parimi e kriteri kryesor për përcaktimin e një oferte si fituese nuk është çmimi më i ulët, por vlera më e mirë që mund të përfitohet nga paraja (publike), ose e thënë ndryshe, shërbimi/malli/puna më e mirë duke përmbushur kriteret kualifikuese, që mund të blihet me çmimin më të ulët që i siguron ato.

Për sa më sipër pretendimi i ankimesit qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Totila” sh.p.k. & “Rafin Company” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-32766-08-05-2019, me objekt “Mirembajtja e objekteve ndertimore ne Spitalin Rajonal Berat”, me fond limit 5.333.347 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 16.08.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Eril B&B” sh.p.k. & “Adriatik” sh.p.k., dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara, duke e skualifikuar këtë bashkim operatorësh ekonomikë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Totila” sh.p.k. & “Rafin Company” sh.p.k. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1476 Protokoli

Datë 09.09.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha